



Planuar / Ditezuar Planned / Produced Rectified / Delivered	27 - 19	2020	0	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKM/SJKK	28/10/2020	1/3	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

Anr.302/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.302/2020 të datës 13.10.2020 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED] kundër organit të punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “*masë disiplinore-vërejtje me shkrim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si bazuar ankesa numër A.nr.302/2020 e datës 13.10.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED].

II. SHFUQIZOHET Vërejtje me shkrim e datës 01.10.2020 me numër DQIPGJ.291/20 nga Drejtori i Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pyltlarisë dhe Gjyctisë dhe të gjitha vendimet tjera që rrjedhin nga vërejtje me shkrim.

III. OBLIGOHET Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi, duke ju bërë kompenzimi i ndalesës së meditjes nga paga mujore e muajit tetor dhe largimi i vërejtjes me shkrim nga dosja personale e ankueses.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED], e punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës në vendin e punës “Inspektore për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunimit të Drurit”, në Drejtorin e Inspektoratit Qendror të Pyltlarisë dhe Gjyctisë, sipas aktë emerimit të datës 31.12.2013, e cila i ka mbikëqyrës të drejtëpërdrejtë Udhëheqësin e Sektorit të Inspektoriatit të Pyltlarisë në DIPGJ. Me datë 16.07.2020 ankueses i është aprovuar kërkesa e pushimit vjetor, nga mbikqyrësi i drejtëpërdrejtë, për periudhën kohore duke filluar nga data 20.07.2020 deri me datë 04.08.2020, përmes formës elektronike SBMNJ-së.

Ankuesja me datë 05.08.2020, përmes E-mailit zyrtar, në mungesë të mbikqyrësit ka njoftuar Drejtorin e Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë dhe zyrën e personelit lidhur me mos paraqitjen e saj në punë me datë 05.08.2020, me arsyetimin se gjatë periudhës së pushimit vjetor ka qenë festa e Kurban Bajramit me datë 31.07.2020, dhe se i takon edhe një ditë e pushimit vjetor. Të njëjtën ditë Drejtori i Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë, përmes E-mailit zyrtar e njofton ankuesen se duhej të ishte paraqitur në punë me datë 05.08.2020 sipas kërkesës së pushimit vjetor të aprovuar me datë 16.07.2020, ku dhe i ka vendosur mbishkrim në formularin fizik të evidencës së ardhjes në punë të datës 05.08.2020, që ankueses ti ndalet meditja nga paga mujore.

Me datë 06.08.2020 ankuesja është paraqitur në punë dhe në formularin fizik të evidencës të datës 05.08.2020 e kishte pa mbishkrim për ndalesën e meditjes nga paga mujore, lidhur me këtë ankuesja vendos shënim sqarues se i lejohet shtyrja e pushimit vjetor gjatë pushimit nëse ka festë zyrtare, në bazë të ligjit.

Me datë 30.09.2020 Drejtori i Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë, gjatë verifikimit të formularëve të evidencës së ardhjes në punë, gjenë se ankuesja ka bërë ndërhyrje në formularë me datë 05.08.2020, për të cilën çështje përmes E-mailit zyrtar i është kërkuar ankueses që të deklarohet me shkrim, për ndërhyrjen e saj në formularin e evidencës, pa autorizim dhe jashtë kompetencës së saj, e cila me datë 01.10.2020 përmes formularit zyrtar me nr.220/2020 DQIPGJ, deklarohet me shkrim në kërkesën e datës 30.09.2020.

Drejtori i Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë, me datë 01.10.2020 i ka shqiptuar masën disiplinore *"Vërejtje me shkrim"*, ankueses [REDACTED] [REDACTED] me numër DQIPGJ.291/20.

Ankuesja e pakënaqur me masën disiplinore të shqiptuar *"Vërejtje me shkrim"*, me numër DQIPGJ 291/2020 të datës 01.10.2020, ka parashtruar ankesë me datë 13.10.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër 2070/2020, me pretendimet ankimore se vërejtja me shkrim i është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 23.10.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Agjencia e Pyjore e Kosovës, me datë 03.11.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Pyjore e Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokoll 2070/2020 të datës 13.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim zyrtar Nr.220/20 e datës 01.10.2020-deklarata; E-mail i datës 30.09.2020; Vërejtje me shkrim Nr.291/2020 i datës 01.10.2020 me numër DQIPGJ.291/20; E-mail i datës 05.08.2020; Lista e evidencës e ardhjes në punë e datës 05.08.2020; Kërkesa për pushim vjetor e datës 30.07.2020; Lista e pages nga data 01.08.2020 deri me datë 30.08.2020; Përgjigje në ankesë e datës 03.11.2020; Kërkesë E-mail i datës 05.11.2020 për prova shtesë; Prova shtesë: E-mail i datës 05.08.2020 nga Drejtori i Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë; Formulari i datës 01.10.2020 me nr.220/2020 DQIPGJ; Akte emërimi ZPD-281/2013 i ankueses i datë 31.12.2013; Formulari i rezultateve të detyrave të punës për vitin 2018; Formulari i rezultateve të detyrave të punës për vitin 2019; E-mail-Përgjigje prova shtesë të datës 13.11.2020; Kërkesë për pushim vjetor i datës 24.07.2020; Lista e pagës nga data 01.10.2020 deri me datë 31.10.2020 lidhur me ndalesën; E-mail i datës 29.09.2020; Kërkesë për pushim vjetor i datës 29.09.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses ██████████ është e bazuar :

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se 'Vërejtje me shkrim' e shqiptuar ndaj saj , me datë 01.10.2020 dhe urdhëri për ndalesën e meditjes për datën 05.08.2020 nga paga mujore, nga Drejtori i Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pylttarisë dhe Gjuetisë, është kundërshtim me ligjin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses janë të qëndrueshme, sepse me datë 01.10.2020 Drejtori i Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pylttarisë dhe Gjuetisë, ndaj ankueses ██████████ ka shqiptuar masën disiplinore 'Vërejtje me shkrim' dhe në bazë provave shtesë të datës 13.11.2020 i është bërë ndalesa e meditjes nga paga mujore, në bazë të listës së pagave të muajit tetor, sepse kjo masë është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 48 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: "Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë" sepse shqiptimi i masave disiplinore shqiptohen duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Rregullores (QRK)Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohet se: "1. Kompetent për shqiptimin e masave disiplinore sipas kësaj Rregullore janë: 1.1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe 1.2. Komisioni Disiplinor", e jo siç ka vepruar Drejtori i Drejtoratit të Inspektoratit Qendror të Pylttarisë dhe Gjuetisë, i cili në rastin konkret nuk është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, prandaj kolegji ka marrë parasysh këtë rrethanë si një ndër arsyet kryesore që ka bërë aprovimin e ankesës së ankueses.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndal ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.302/2020**

Zyle Millaku Gojnovci
Procesmbajtëse

Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses ██████████
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë Pyjore të Kosovës
- Arkivit të KPMSHCK-së.